



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2021:275955

Datë: 23.11.2022

Numri i dokumentit: 03680638

P.nr.2021/275955

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC/Departamenti i Përgjithshëm–Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Mizahir Shabani, me bashkëpunëtorin profesionale Adelina Çmega, duke vendosur në lëndën penale kundër të akuzuarit **L. D.** nga fshati Krushë e Madhe, Komuna e Rahovecit, për shkak të veprës penale kanosje nga neni 181 par.2 të KPRK-së dhe veprës penale Dhuna në Familje nga neni 248/1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Gjakovë/Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.1696/2021 të datës 07.12.2021, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar dhe publik, në prezencën e përfaqësuesit të akuzës Prokurorit të Shtetit Qazim Xharra i akuzuari L. D. së bashku me mbrojtësin av. G. Sh. nga Rahoveci, më datë 14.11.2022, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari,

L. D., nga i ati M., e ëma F., e lindur K., i lindur më datë ... në fshatin Krushë e Madhe, Komuna e Rahovecit, ku edhe banon, me numër personal ..., punëtorë, gjendja ekonomike e dobët, ka të kryer shkollën e mesme, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

S E P S E

I.Me datë 16.11.2021, rreth orës 21:30/h në fshatin Krushë e Madhe, Komuna e Rahovecit, i pandehuri seriozisht e kanos presonin tjetër, këtu të dëmtuarën ish bashkëshorten e tij M. A. se do ta privojë nga jeta, në atë mënyrë që pasi e thërret në telefon vajzën e tij G. D., për shkak të pakënaqësisë pasi që e njëjta pa pëlqimin e tij kishte shkuar në shtëpinë e ish bashkëshortes së tij, në një moment i drejtohet me fjalët “nëse nuk kthehesh në shtëpi deri në ora 22:30, ja ka me mbyt veten ja ka me mbyt ata me shku në burg”, duke aluduar në të dëmtuarën

M. A. me çrast me këto veprime të dëmtuarës i ka shkaktuar frikë dhe shqetësim për jetën dhe sigurinë e saj.

-Këso dore ka kryer veprën penale Kanosje nga neni 181 par.2 të KPRK-së,

II.Me datë 16.11.2021, rreth orës 21:30/h në fshatin Krushë e Madhe, Komuna e Rahovecit, i pandehuri me qëllim të cenimit të dinjitetit të personit tjetër brenda një marrëdhënieje familjare shkaktonte keqtrajtimin psikologjik të vajzës së tij, këtu të dëmtuarës G. D., në atë mënyrë që pasi e thërret në telefon vajzën e tij G. D., për shkak të pakënaqësisë pasi që e njëjta pa pëlqimin e tij kishte shkuar në shtëpinë e ish bashkëshortes së tij, në një moment i drejtohet me fjalët “pse ke shku pa pëlqimin tim, a më ke pyet mua se je tu shku, a ki qejf me pa babën tënd në burg, veç vazhdo me mend të saj, me dal rrugëve me mend të asajna, ke me pa babën tënd në burg, ke me mbet pa babë, nëse nuk kthehesh në shtëpi deri në ora 22:30, ja ka me mbyt veten ja ka me mbyt ata me shku në burg” dhe me fjalë të tjera me të cilat tek e dëmtuara ka shkaktuar ndjenjën e frikës, pa sigurisë dhe shqetësim emocional.

Andaj, gjykata në bazë të nenit 4, 6, 7, 17, 38, 39, 43, 69, 70, 181 par.2 dhe nenit 248/1 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPK-së, të akuzuarit i shqipton:

DËNIMIN ME GJOBË

Për veprën penale si në dispozitivin e **I.** të këtij aktgjykimi në shumë prej **dyqind (200) €**. e cila gjobë duhet të paguhet në afat prej 15 ditëve nga plotëfuqishmëria e këtij aktgjykimi si dhe

DËNIMIN ME KUSHT

Dënimin me burgim në kohëzgjatje prej nëntëdhjetë (90) ditëve, si dhe dënim me gjobë në shumë prej **dyqind (200) €**. për veprën penale si në dispozitivin e **II.** të këtij aktgjykimi, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afat prej një (1) viti, nga plotëfuqishmëria e aktgjykimit, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

E dëmtuara M. A. A. nga Rahoveci, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Detyrohet i akuzuari që të paguajë shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumë prej tridhjetë (30) euro, si dhe për fondin e kompensimit të viktimave të krimit shumë prej tridhjetë (30) euro e të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

1. Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur aktakuzën PP.II.nr.1696/2021 të datës 07.12.2021, kundër të akuzuarit L. D. nga fshati Krushë e Madhe,

Komuna e Rahovecit, për shkak të veprës penale kanosje nga neni 181 par.2 të KPRK-së, dhe veprës penale Dhuna në Familje nga neni 248/1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestar me datë 14.11.2022, ku prezent kanë qenë përfaqësuesi i akuzës Prokurori i Shtetit Qazim Xharra, i akuzuari L. D. së bashku me mbrojtësin av. G. Sh. nga Rahoveci, sipas autorizimit, ndërsa nuk ka qenë prezent e dëmtuara, për të cilën gjykata ka provë se është ftuar në mënyrë të rregullt, mungesën e vetë nuk e ka arsyetuar.

Aktakuza me numër PP.II.nr.1696/2021 të datës 07.12.2021, u lexua dhe u arsyetua nga prokurori i shtetit Qazim Xharra. I akuzuari ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën për të cilën akuzohet.

Gjyqtari i vetëm gjykues pasi është bindur se i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën, të njëjtit i ka dhënë mundësinë e pranimit ose mospranimit të fajësisë, si dhe gjykata e ka njoftuar lidhur me efektet dhe pasojat e pranimit të fajësisë.

2. Vlerësimi i pranimit të fajësisë

I akuzuari ka deklaruar se e pranon fajësinë sipas të gjitha pikave të aktakuzës, e ndjen vetën fajtor për këtë veprë penale për të cilën ngarkohet, dhe se ndjen keqardhje për rastin që ka ndodhur. I ka premtuar gjykatës se një premtim i tillë nuk do të përsëritet dhe i ka propozuar gjykatës që të ketë mirëkuptim në shqiptimin e dëmit.

Mbrojtësi i të akuzuarit – avokati G. Sh. deklaroi se: duke pasur parasysh faktin se i mbrojturi i tij i vetëdijshëm për pasojat juridike të pranimit të veprës penale pas konsultimeve i njëjti i ka pranuar veprat penale për të cilat ngarkohet andaj duke marrë për bazë këtë fakt pasi që i mbrojturi i tij ka pranuar veprën për të cilën ngarkohet i ka propozuar gjykatës që gjatë vendosjes lidhur me dënimin të merr parasysh pranimin e fajësisë sjelljen korrekte të tij po ashtu është familjar ka gjendjen të dobët ekonomike, andaj i ka propozuar gjykatës nga të cekurat më lartë ndaj të mbrojturit të tij ti shqiptoj një dënim sa ma të butë pasi që edhe me një dënim i tillë mundë të arrihet qëllimi i dënimit.

Prokurori i Shtetit Qazim Xharra, jep mendimin lidhur me pranimin e fajësisë i cili ka deklaruar se: nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në këtë shqyrtim gjyqësor, pasi që pranimin e fajësisë e ka bërë me vullnet të lirë pas këshillimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij po ashtu se fakti se pranimi i fajësisë mbështetet në fakte që përmban aktakuza dhe pasi i ka kuptuar të drejtat, respektivisht favoret dhe pasojat e pranimit të fajësisë, po ashtu duke marrë për bazë se aktakuza ka mbështetje në provat materiale dhe personale në bazë të cilave është paraqitur gjendja faktike në dispozitiv të saj ku edhe përmbushen të gjitha elementet e veprës penale për të cilat ngarkohet i akuzuari. Dhe se provat të cilat janë të ligjshme andaj i propozojë gjykatës që i njëjti të shpallet fajtor dhe të njëjtit ti shqiptojë një dënim të paraparë ligjor, duke marrë parasysh shkallën e përgjegjësisë dhe rrezikshmërisë së veprës penale për të cilën ngarkohet, gjithashtu me rastin e vlerësimit dhe caktimit të llojit dhe lartësisë të dënimit të ketë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese e posaçërisht ato rënduese për faktin se vepra penale është kryer brenda marrëdhënieve familjare.

Gjykata konform dispozitave të nenit 365 të KPPK-së, e pasi që janë plotësuar kushtet e parapara sipas dispozitave të nenit 326 të njëjtit Kod, për shkak se i akuzuari në fillim të seancës

të shqyrtimit fillestar është deklaruar i fajshëm, në tërësi ka pranuar veprën penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata nuk është lëshuar në procedurën e administrimit të provave.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike: se i akuzuari L. D., me dashje ka kryer veprën penale Kanosje nga neni 181 par.2 të KPRK- së, si dhe veprën penale Dhuna në Familje nga neni 248/1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

4. Elementet e veprës penale

Në nenin 181 par.2 të KPRK-së, është parashikuar se formën themelore të veprës penale kanosje:“ **Kushdo që seriozisht e kanos personin tjetër me fjale, vepra apo gjeste se do ta privoj nga liria ndonjë person tjetër ose do ta dëmtoj me arme zjarri, me shpërthim ose me mjete tjera të rrezikshme, dënohet me gjobe ose me burgim deri në një (1) vit“.**

Në nenin 248 par.1 të KPRK-së, është parashikuar se formën themelore të veprës penale Dhuna në Familje.” **1. Kushdo që e kryen dhunën ose keqtrajtimin fizik, psikologjik ose ekonomik me qëllim të cenimit të dinjitetit të personit tjetër brenda një marrëdhënieje familjare, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në 3 (tre) vjet“.**

5. Vendimet e gjyqtarit të vetëm gjykues

Gjyqtari i vetëm gjykues, pas pranimit të fajësisë nga i akuzuari, ka gjetur se i njëjti ka kryer veprën penale kanosje nga neni par.181 par.2 të KPRK – së, dhe gjendjen e tillë faktike e mori ashtu sikurse ishte përcaktuar në aktakuzë dhe provat materiale të cilat i përmbante aktakuza, e të cilat janë:

- Deklarata e të dëmtuarës M. A. e dhënë ne polici;
- Deklarata e dëmtuarës G. D. e dhënë në polici;
- Deklarata e të pandehurit L. D. e dhënë në polici; dhe
- CD me video incizim;

Gjykata ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata ka vendosur ta shpallë fajtor dhe ta gjykojë në bazë të ligjit.

6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Me rastin e caktimit dhe matjes së dënimit, gjykata ka marrë parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit sipas nenit 69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, ashtu që si rrethanë lehtësuese ka marrë sjelljen korrekte të të akuzuarit në gjykim, është penduar për veprimin e bërë, është hera e parë që ndeshet me ligjin, i njëjti është deklaruar i fajshëm, se i vjen keq për rastin e ndodhur, si dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të përsërisë një veprim të tillë, ndërsa rrethana veçanërisht rënduese gjykata nuk gjeti, andaj të njëjtit ia ka shqiptuar dënimin me gjobë me shpresë dhe bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit të paraparë me dispozitat e nenit 38 të KPRK-së.

7. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarës që kërkesën pasurore – juridike ta realizojë në procedurën e rregullt civile bazohet në nenin 463 të KPPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale u mor konform nenit 450 paragrafi 1 dhe 2 nënparagrafi 2.6, lidhur me nenin 453 par. 1 të KPPK-së, ndërsa vendimi për kompensimin e viktimave të krimit u mor në kuptim të nenit 39 paragrafi 3 nënparagrafi 3.1 të Ligjit Nr.05/L – 036, për kompensimin e viktimave të krimit.

Nga sa u tha më lartë, e në vështrim të nenit 365 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal
P.nr.2021:275955, me datë 14.11.2022

B. Profesionale
Adelina Çmega

Gjyqtari i vetëm gjykues
Mizahir Shabani

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit, nëpërmjet kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.